

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
 ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 96/20  
 Datë/Datum. 10.02.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **"KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË" SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KMDK-19-8038-1-1-1**

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me një kamion për transportimin e mbeturinave"**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Grupi i OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K.  
*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

Rr.Anton Santori, Lgj.Qendresa  
*(Adresa)*

Prishtinë 10000  
*(Vendi) (Kodi postar)*

044550922   
*(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)*

Arianit Morina  
*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

hpishpk@gmail.com  
*(Adresa elektronike)*

10.02.2020  
*(Data e parashtrimit të kërkesës)*



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: "Furnizim me një kamion për transportimin e mbeturinave".

Njoftimi për kontratë është bërë me datën 22.10.2019 ndërsa hapja publike është bërë me datë 11.11.2019.

Njoftimi i parë për vendimin e AK është bërë me 12.11.2019.

Të pakënaqur me vendimin e AK një OE konkurrent kishte bërë ankesë dhe lënda ishte kthyer në Ri-vlerësim.

Pas ri-vlerësimit AK kishte bërë njoftimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me datë 16.01.2020. Për çudi ky vendim anulohet menjëherë të nesërmen me datë 17.01.2020 me arsyetimin “për çështje teknike”.

Njoftimi tjetër mbi vendimin e AK bëhet me datë 23.01.2020 ku AK e shpërblen me kontratë prapë OE “Ballkan Petrol” SHPK.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, ne Grupi i OE “HPI” SH.P.K. dhe “KOSOVA MOTORS GROUP” SH.P.K. në afat të rregullt kohorë me datë 28.01.2020 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK.

AK me datë 30.01.2020 na ka kthyer përgjigjen në kërkesë tonë duke e refuzuar këtë kërkesë, andaj të pakënaqur me këtë vendim të AK, ne Grupi i OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K. në afat të rregullt kohorë parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së.

Kriteri për vlerësim ka qenë Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm sipas nën kriterëve:

1	Çmimi	60%
2	Afati i liferimit ne dite	30%
3	Periudha e garancionit ne vite	10%

#### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja publike është bërë me datë 30.07.2019. Nga procesverbali i hapjes publike shihet se hapja publike është bërë në përputhje me njoftimin dhe në të nuk është e evidentuar ndonjë vërejtje rreth mbarëvajtjes së këtij procesi.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

**Sipas njoftimit nga AK ne jemi konsideruar si tenderues i pasuksesshëm!**

#### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Të pakënaqur me vendimin e AK-së, ne Grupi i OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K. në afat të rregullt kohorë me datë 28.01.2020 kemi parashtuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK.



AK me datë 30.01.2020 na ka kthyer përgjigjen në kërkesën tonë duke e refuzuar këtë kërkesë, andaj të pakënaqur me këtë vendim të AK-së, ne Grupi i OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K. në afat të rregullt kohorë parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita të LPP dhe RUOPP.

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP të amandamentuar,
2. AK ka shkelur nenin 13 të LPP të amandamentuar,
3. AK ka shkelur nenin 56.1 të LPP të amandamentuar,
4. AK ka shkelur nenin 59 të LPP të amandamentuar,
5. AK ka shkelur nenin 60 të LPP të amandamentuar,
6. AK ka shkelur nenin 69 të LPP të amandamentuar
7. AK ka shkelur nenin 72 të LPP të amandamentuar,
8. AK nuk ka respektuar Vendimin e OSHP-së nr. 853/19 të datës 09.01.2020.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

**Pretendimi 1:** AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së sepse nuk i ka trajtuar të gjithë OE njëjloj pasi që dy nga kompanitë konkurruese kanë pasur mangësi të theksuara në ofertat e tyre ndërsa AK i trajton si të përgjegjshme. Nenin 7 të LPP e ka shkel edhe me rastin e kërkesës për sqarime sepse ka pranuar dokumente shtesë që po ashtu nuk i kanë plotësuar kushtet për tu trajtuar si të rregullt ndërsa AK i pranon si të tilla dhe njërin nga këta OE e shpall edhe

fitues të tenderit. Ky veprim konsiderohet shkelje e nenit 7 të LPP-së

**Pretendimi 2:** AK ka shkelur nenin 13 të LPP-së pasi që me rastin e sqarimeve të tenderit të OE “Ballkan Petrol” ka pranuar dokumente që nuk janë në njërën nga gjuhët zyrtare që i lejon LPP-ja. Këto dokumente janë kërkuar nga AK me kërkesë për sqarim të tenderit pa të cilat ky OE ka qenë i papërgjegjshëm ndërsa me rastin e sjelljes së këtyre dokumente shihet se ata janë në gjuhën Çeke dhe nuk janë fare të përkthyer.

**1. ZÁKLADNÍ TECHNICKÉ ÚDAJE A TECHNICKÉ PARAMETRY:**

Druh zařízení:	hákový nakladač kontejnerů
Typ:	Multilift XR21 Z59
Nosnost:	21 000 kg (viz poznámky)
Výrobní číslo:	nástavba - X21Z5975039433 podvozek - WMA30SZZ2KP132765
Rok výroby:	2017
Výrobce:	podvozek - MAN nástavba - Multilift montážní organizace - Contsystem s.r.o.
Třída ZZ:	nezařazeno
Umístění ZZ:	pevná montáž na podvozku
Tech. údaje zařízení:	Druh ovládání: manuální ovladačem z kabiny vozidla, nouzové na hydraulickém rozvaděči. Hydraulické čerpadlo: SAP 084

Një sqarim më të detajuar e gjeni tek **pretendimi 3**.

Sipas nenit 13 të LPP-së vetëm dokumente në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze duhet të pranohet si të rregullta dhe në rastin kur një OE sjell dokumente të tilla atëherë duhet të konsiderohet si i papërgjegjshëm. Veprimi i tillë konsiderohet shkelje e nenit 13 të LPP-së.

**Pretendimi 3:** AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar fare paragrafin 4 (katër) të këtij neni. Neni 59.4 decidivisht kërkon që:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Pavarësisht kësaj AK ka konsideruar si të përgjegjshëm OE “Ballkan Petrol SHPK” edhe pse i njëjti ka mangësi të konsiderueshme në ofertën e tijë. Mungesat që shihen qartë se i posedon ky OE janë:

- Deklarata e liferimit përpos që është deklarata mashtruese sepse nuk ka shanse as teorike që liferimi të bëhet për tre ditë e njëjta e ka edhe elemente kufizuese ku si kohë për fillimin e numërimit të këtij afati OE e ka shtuar edhe atë që ky afat vlen nga lëshimi i urdhër blerjes nga AK. Në kontratat e tilla nuk ka urdhër blerje por afati i liferimit fillon me rastin e nënshkrimit të kontratës e bazuar në këtë shihet se ka tendenca për manipulim me këtë kriter. Manipulimet e tilla nuk janë risi ku edhe përkundër që është nënshkruar kontrata AK nuk e ka lëshuar kërkesën për kohë të gjata deri sa OE janë përgatitur. Kjo urdhër blerje nuk është e nevojshme fare te ky lloj i kontratave për OE e ka futur qëllimisht me manipulua me afatin e liferimit pasi që edhe ai vet e din që liferimi për tre ditë i kësaj makinerie është e pamundur. Pra nga ky



sqarim del që kjo deklaratë është me kufizime dhe si e tillë nuk është e pranueshme.

- Ky OE ka ofruar katalogje që nuk ofrojnë mjaftueshëm informata se me çfarë makinerie ka ofertua duke lënë mundësi opsionale edhe pse në dosje kjo nuk ishte ofruar si mundësi, referencat për liferime të ngjashme nuk i ka ashtu siç janë kërkuar sepse shumica janë për buldozer dhe makineri që nuk kanë fare ngjashmëri me kamionin e kërkuar nga AK.
- OE që AK e ka shpallur fitues nuk posedon fare veprimtarit në certifikatën e biznesit të cilat ia lejojnë të merret me këtë lloj biznesi. Në këtë certifikatë askund nuk e posedon veprimtarin për shitje të makinerive, automjeteve por as edhe pjesëve të tyre. Pra kjo bie ndesh me kërkesat e AK që i ka vendosur në FDT si kërkesa të përshtatshmërisë profesionale. Nga ky fakt shihet se ky OE nuk e plotëson kërkesën e dosjes mbi mundësit profesionale dhe si i tillë është edhe i papërgjegjshëm.
- Ky OE nuk i plotëson as kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale pasi që nuk e posedon autorizimin e prodhuesit për makinerinë që ka ofertuar. Kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar për shitjen e kesaj makinerie.	Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar.
---	---	---

OE në fjalë ka ofruar një autorizim nga një kompani që sipas tyre mirret me shitjen e këtyre kamionëve mirëpo askund nuk ka dëshmuar se kjo kompani është e autorizuar si distributor për shitje të makinerive që ka ofertuar. Bazuar në këtë, ky OE nuk ka plotësuar këtë kusht dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm. Nuk ka logjik që një OE të ofroj garancion të prodhuesit ndërsa vet ofertuesi nuk është fare i autorizuar për shitje dhe servisim të këtyre makinerive. Përpos kësaj as lëshuesi i këtij “autorizimi” nuk ka ofruar dëshmi se është i autorizuar si distributor për shitje të kamionëve të tipin MAN. Sipas web faqes së prodhuesit të kamionëve të tipit MAN shihet se Kompania “AUTOMARKET TRUCKS s.r.o” me seli në Brno, Republika e Çekisë, nuk është si distributor i autorizuar për shitje të këtyre kamionëve andaj edhe autorizimi i leshur për OE “Ballkan Petrol” është i pavlefshëm. Në linkun që po ju ofrojmë mundeni të i gjeni të gjithë distributorët e autorizuar nga MAN. Tek Republika Çeke ka disa distributor por “AUTOMARKET TRUCKS s.r.o” nuk është njëri nga ata. Te ky link mundeni ta shihni edhe distributorin e autorizuar për republikën e Kosovës. Në bazë të autorizimit dhe webfaqes së prodhuesit MAN, shihet se “AUTOMARKET TRUCKS s.r.o” ka deklaruar rrejtshëm për gjoja se janë si distributor të autorizuar. Shiko link-un dhe autorizimin e bashkangjitur.

<https://ws-public.man-mn.com/siit/mansettlementwebapp/public/client/index.html?lang=en>

Dëshmitë në kopje fizike lidhur me atë se kush është i autorizuar për Republikën Çeke i keni të bashkangjitura si dokumente.

Përpos kësaj askund nuk ka treguar se ka autorizim për pajisen mbi ndërtuese siç është vinçi i cili bënë ngarkimin dhe shkarkimin e kontejnerit. Kjo tregon se ky OE nuk posedon asnjërin nga autorizimet e nevojshme për makinerinë që ka ofertuar dhe

se nga aspekti i mundësive teknike dhe profesionale del të jetë plotësisht i papërgjegjshëm. Dokumenti(autorizimi) i tillë duket qartë se nuk ka lidhje me prodhuesin MAN por është një autorizim e krijuar nga vet kompania për gjoja janë të autorizuar për shitjen e kamionëve pa e cekur as emrin e prodhimeve për të cilat ata janë të autorizuar. Ndërsa tek vendi ku e autorizon "Ballkan Petrol"-in e ndryshon të dhënat rreth asaj se për çka e autorizon me të vetmin qëllim, ikjen e përgjegjësis për deklarime të rrejshme.

### AUTHORIZATION

Date: 05.11.2019

For: "KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY "J.S.C.

Address: Rr.Bekim Fehmiu Nr.137

Place: Prishtina 10000, Kosovo

WHEREAS, AUTOMARKET TRUCKS s.r.o. who are distributor of trucks in Czech Republic having address at: Lidická 1001/25b, CZ-60200 Brno, Czech Republic.

Do hereby authorise: "BALLKAN PETROL" SH.P.K. having address: Zona Industriale Gerlice, Ferizaj, Kosovo to submit a tender – "Supply with a truck for waste transportation", Procurement No. KMDK-19-8038-1-1-1; Internal No. 19/020/111, and subsequently negotiate and sign the Contract with you for the Hooklift Truck MAN TGS 33.460, 6x4, B1 sold by our company


  
AUTOMARKET TRUCKS s.r.o.  
Lidická 1001/25b, 60200 Brno  
IČ: 29261392, DIČ: CZ29261392  
www.ausomarket.cz  
01

- OE Ballkan Petrol SHPK ka marr kërkesë për sqarim nga AK por sqarimet që i ka ofruar ka futur dokumente që sipas nenit 13 të LPP konsiderohen si të pa pranueshme andaj edhe në këtë pikë lirisht mund të themi se ky OE nuk është i përgjegjshëm pasi që nuk ka ofruar si duhet dëshmitë e kërkuara nga AK sipas nenit 72 të LPP. Dokumentet e tilla duken kështu:



# **1. ZÁKLADNÍ TECHNICKÉ ÚDAJE A TECHNICKÉ PARAMETRY:**

Druh zařízení: hákový nakladač kontejnerů  
Typ: Multilift XR21 Z59  
Nosnost: 21 000 kg (viz poznámky)  
Výrobní číslo: nástavba - X21Z5975039433  
podvozek - WMA30SZZ2KP132765  
Rok výroby: 2017  
Výrobce: podvozek - MAN  
nástavba - Multilift  
montážní organizace - Contsystem s.r.o.  
Třída ZZ: nezařazeno  
Umístění ZZ: pevná montáž na podvozku  
Tech. údaje zařízení: Druh ovládání: manuální ovladačem z kabiny vozidla,  
nouzové na hydraulickém rozvaděči.  
Hydraulické čerpadlo: SAP 084



TC 146290

CZECH REPUBLIC

TECHNICKÝ POPIS SAMOSTATNÉHO TECHNICKÉHO CELKU		ZMĚNA
ZTP č.:	ES č.:	(ZTP)
1 Druh: Samostatný technický celek-HNJ		
2		
3 Tovární značka: Multilift		
4 Typ: Multilift XR 212.59		
5 Obchodní označení: Multilift XR 212		
6 Identifikační číslo: X21Z5975039433		
7 Celková délka [mm]: 6 583 8 šířka: 1 118 9 výška: 1 570		
10 Rozměry ložné plochy [mm]: - délka 11 šířka		
12 Objem cisterny - skříně [m³]:		
13 Provozní hmotnost [kg] 2 810		
14 Největší technicky přípustná/povolená hmotnost [kg]:		
15 Spojovací zařízení - druh a typ:		
16 Nejvyšší rychlost [km.h⁻¹]:		
Další údaje viz Další záznamy:		



ČESKÁ REPUBLIKA  
VÝPIS TECHNICKÉHO OSVĚDČENÍ

SAMOSTATNÉHO TECHNICKÉHO CELKU Č. TC 146290

TECHNICKÝ CELEK SE SHODUJE S TYPEM SCHVÁLENÝM MINISTERSTVEM DOPRAVY POD ČÍSLEM C-2349

Druh  
Sam.tech.celek-HNJ

TOVÁRNÍ ZNAČKA, TYP  
Multilift XR 212.59

IDENTIFIKAČNÍ ČÍSLO  
X2125975039433

DATUM VYSTAVENÍ 22.11.2019

PODPIS

CONTSYSTEM s.r.o.  
Nám. 14. října 1307/2  
150 00 Praha 5, Smíchov  
IČ: 27793486 DIČ: CZ27793486

AK nuk ka respektuar nenin 49.4 të LPP as kur e ka konsideruar si të përgjegjshëm OE “Grami SHPK” edhe pse i njëjti ka mangësi të konsiderueshme në ofertën e tij. Mungesat që shihen qartë se i posedon ky OE janë:

- Ky OE nuk e plotëson kërkesën mbi mundësit teknike dhe profesionale pasi që nuk e posedon autorizimin e prodhuesit për makinerinë që ka ofertuar sepse kërkesa në dosjen e tenderit ka qenë kështu:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar për shitjen e kësaj makinerie.	Autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar.

OE në fjalë ka ofruar një autorizim nga një kompani që sipas tyre mirret me shitjen e këtyre kamionëve mirëpo askund nuk ka dëshmuar se kjo kompani është e autorizuar si distributor për shitje të makinerive që ka ofertuar. Bazuar në këtë ky OE nuk ka plotësuar këtë kusht dhe si i tillë duhet të konsiderohet i papërgjegjshëm. Nuk ka logjik që një OE të ofroj garancion të prodhuesit ndërsa vet ofertuesi nuk është fare i autorizuar për shitje dhe servisim të këtyre makinerive. Përpos kësaj as lëshuesi i këtij “autorizimi” nuk ka ofruar dëshmi se është i autorizuar si distributor për shitje të kamionëve të tipin Mercedes.

Sipas web faqes së prodhuesit të kamionëve të tipit MERCEDES shihet se Kompania Turke “SANCAKLI” nuk është si distributor i autorizuar për shitje të këtyre kamionëve andaj edhe autorizimi i leshur për OE “Grami SHPK” është i pavlefshëm. Në linkun që po ju ofrojmë mundeni të i gjeni të gjithë distributorët e autorizuar nga MERCEDES për territorin e Turqisë ku ka disa distributor por “SANCAKLI” nuk është njëri nga ata. Në bazë të autorizimit dhe webfaqes së prodhuesit MERCEDES, shihet se “SANCAKLI” ka deklaruar rrejtshëm për gjoja se janë si distributor të

[https://www.mercedes-benz-trucks.com/en\\_ZA/buy/dealer-locator.html](https://www.mercedes-benz-trucks.com/en_ZA/buy/dealer-locator.html)

Shihe autorizimin në vazhdim:



Subject: **Manufacturer's Authorization**

Do hereby authorize [GRAMI sh.p.k address: Str. Xhroxh Bush no 19 Prishtine 10 000 Kosovo,] to submit a bid, and subsequently negotiate and sign the Contract with you against [Furnizim me automjete për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave, Procurement Number: KMDK-19-S038-1-1-1,] for the above goods manufactured by us. Mounted on the chassis Type of th Truck: (Mercedes Arocs 3342 p)

[illegible]



- Mungesë në ofertën e këtij OE konsiderohet edhe deklarata për afatin e liferimit e dhënë me kushte sepse nuk ka shanse as teorike që liferimi të bëhet për shtatë ditë si dhe e njëjta e ka edhe elemente kufizuese ku si kohë për fillimin e numërimit të këtij afati OE e ka shtuar edhe atë që ky afat vlen nga lëshimi i urdhër blerjes nga AK. Në kontratat e tilla nuk ka urdhër blerje por afati i liferimit fillon me rastin e nënshkrimit të kontratës e bazuar në këtë shihet se ka tendenca për manipulim me këtë kriter. Manipulimet e tilla nuk janë risi ku edhe përkundër që është nënshkruar kontrata AK nuk e ka lëshuar kërkesën për kohë të gjata deri sa OE janë përgatitur. Kjo urdhër blerje nuk është e nevojshme fare te ky lloj i kontratave për OE e ka futur qëllimisht me manipulua me afatin e liferimit pasi që edhe ai vet e din që liferimi për tre ditë i kësaj makinerie është e pamundur. Pra nga ky sqarim del që kjo deklaratë është me kufizime dhe si e tillë nuk është e pranueshme.

Pra pas krejt këtyre që thamë dhe bazuar edhe në dëshmitë që ne kemi dorëzuar së bashku me ankesën, shihet qartë se AK ka shkelur nenin 59 të LPP me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve dhe si pasojë ka nxjerrë si të përgjegjshëm kompanitë “Ballkan Petrol” dhe “Grami SHPK” e që sipas dëshmive dhe fakteve që ju ofruam ne, këto kompani janë të papërgjegjshme.

**Pretendimi 4:** AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së ku si pasojë e mos respektimit të neneve tjera që i kemi cekur ka shpërblyer me kontratë një OE që ka ofertuar me një tender të papërgjegjshëm ndërsa AK thirret në atë që gjoja është ekonomikisht më i favorshëm. AK këtu ka shkelur edhe nenin 56.1 të LPP ku tenderët së pari duhet të vlerësoheshin për nga përgjegjshmëria e më pas sipas kriterëve të vlerësimit që në rastin konkret ka qenë ekonomikisht më i favorshëm. Si pasojë e kësaj AK rrezikon të dëmtojë buxhetin për një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare (52000€ më të shtrenjta apo mbi 35%). Sikur të i kish trajtuar si duhet ofertat gjatë procesit të vlerësimit dhe ri-vlerësimit, AK do të kursente nga buxheti shumë e cekur që nuk është e vogël, prandaj bazuar në këtë pretendim se AK ka shkelur nenin 60 të LPP lidhur me mosrespektimin e kriterit **Tenderi i Përgjegjshëm Ekonomikisht më i favorshëm**.

**Pretendimi 5:** AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së sepse gjatë vlerësimit të tenderit tonë nuk i ka trajtuar si duhet dëshmitë e ofrura lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale. Si pasojë e kësaj. Ka pranuar autorizime, deklarata të liferimit por edhe dokumente tjera siç janë certifikatat e biznesit dhe dëshmi mbi pranueshmërinë e pajisjes të cilat nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit por edhe ato të LPP-së. Kjo pra konsiderohet mos respektim i kriterëve të vendosura nga vet ata paraprakisht në dosjen e tenderit si dhe konsiderohet edhe shkelje e plot e nenit 69 të LPP-së.

**Pretendimi 6:** AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që nuk e ka shfrytëzuar mundësinë që ja ofron ky nen për sqarimin e tenderëve dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE. Ky nen thotë:



1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.
2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.
3. Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Bazuar në këtë shihet se AK ka pranuar dokumente nga OE Ballkan Petrol si të rregullta edhe pse ato nuk e plotësojnë kriterin e nenit 13 të LPP. AK kontraktues nuk ka vepruar sipas këtij neni as me rastin e mos sqarimit dhe verifikimit të autorizimeve tek prodhuesit përkatës të kamionëve që OE të atakuar i kanë ofertuar. Do të ishte shumë e lehtë që të i shkruhej një letër prodhuesit të Kamionit MAN dhe atij të kamionit MERCEDES dhe të sqarohej çështja e autorizimeve. Me këtë shihet qartë se AK ka shkelur edhe nenit 72 të LPP-së duke mos i shfrytëzuar mundësit e tij për qëllim të respektimit të nenit 1, 6 dhe 7 të LPP-së.

**Pretendimi 7:** AK nuk ka respektuar as vendimin e OSHP i cili e kthen lëndën në rivlerësim dhe u kërkon AK që vlerësimin ta bëjnë duke i respektuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe kërkesat e LPP-së. Sipas këtij vendimi OE që AK e ka shpallur fitues i janë kontestuar, autorizimi, katalogjet, referencat etj. ndërsa AK nuk e ka përfillur këtë vendim dhe ka vepruar prapë njëjtë duke e shpallur fitues.

Është një anomali që me datë 16.01.2020 AK e anulon tenderin dhe të ty këto kompani i shpall të papërgjegjshme ndërsa me datën 17.01.2020 e merr një vendim për anulim të këtij vendimi dhe me datë 23.01.2020 publikon njoftimin tjetër ku prapë e shpall fitues OE e mëhershëm. Kjo është plotësisht e papranueshme dhe në kundërshtim të plotë me rregullat për administrimin e procedurat e prokurimit që i parasheh LPP-ja.

E vetmja është kompania jonë ka ofruar të gjitha dëshmitë e nevojshme dhe të kërkuara, ka ofruar autorizimin e prodhuesit në formën e rregullt dhe ka dhënë afatin liferimit real ashtu siç edhe është dashur ta ofronin të gjithë. Pas kalkulimit të poenëve ne do të fitonim më së shumti poen dhe njëherit do dilnim të parët për nga favorshmëria. Bazuar në këtë ne duhet edhe të jemi fituesit e këtij tenderi sepse kështu do respektohej plotësisht tenin 1 dhe neni 6 i LPP-së nga ana e AK.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara, shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes ankesën tonë kundër vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar duke marrë:

### **V E N D I M**

**APROVOHET** si e bazuar ankesa e Grupit të OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K. lidhur me tenderin "Furnizim me një kamion për transportimin e mbeturinave".

**ANULOHE**t njoftimi mbi vendimin e AK – KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË" SH.A. dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në detyrimet që i ka AK ndaj LPP-së dhe RRUOPP-së e që realisht më pas do të duhej që Fitues të shpallej Grupi i OE "HPI" SH.P.K. dhe "KOSOVA MOTORS GROUP" SH.P.K.






















## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë shumë të gjatë në fushën e furnizimeve të tilla.

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

-  1 B05 Njoftim per Kontrat 22.10.2019
-  2 Dosja e Tenderit 31.10.2019
-  3 Shqip - Përshkrimi i çmimit 21.10.2019
-  4 B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve 04.11.2019
-  5 A-INFORMATA SHITES 01.11.2019
-  6 PROCESVERBALI I HAPIES SE TENDERIT 11.11.2019
-  7 B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES 12.11.2019
-  8 NJOFTIM PER PEZULLIM TE AKTIVITETIT TE PROKURIMIT 18.11.2019
-  9 NJOFTIM PER PEZULLIM TE AKTIVITETIT TE PROKURIMIT 02.12.2019
-  10 NJOFTIM PER ANULIMIN E VENDIMIT TE AK-se 10.01.2020
-  12 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES 16.01.2020
-  13 NJOFTIM PER ANULIMIN E VENDIMIT TE AK-se 17.01.2020
-  14 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES 23.01.2020
-  15 Vendim i OSHP 09.01.2020
-  16 Kërkesë për rishqyrtim 28.01.2020 HPI SHPK
-  17 Vendim i AK - refuzimi i kërkeses per rishqyrtim
-  2 Dëshmite mbi mangesit e OE Ballkan Petrol shpk
-  3 Dëshmite mbi mangesit e OE GRAMI
-  4 Dëshmit lidhur autorizimet e dilerave per MAN dhe MERCEDES

\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.